



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

V E N D I M

NR. 9, DATË 15/ 07 / 2025

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1/6, DATË 05.04.2022 TË
KOMITETIT TË INVESTIMEVE PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT ME
POTENCIAL STRATEGJIK “WHITE ROADS HOTEL”**

Në mbështetje të neneve 9, 18, 21 dhe 29 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut II, pika 8 të VKM-së Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, si dhe bazuar në Vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 1/6, datë 05.04.2022 “Për miratimin e statusit strategjik ‘Investim/Investitor Strategjik, Procedurë e Asistuar’ për projektin e investimit strategjik White Roads Hotel”, si dhe Vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 34/11 datë 01.08.2023 “Për disa shtesa në Vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 1/6 datë 05.04.2022 ‘Për miratimin e statusit ‘Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Asistuar, për projektin e investimit “White Roads Hotel”, me subjekt “White Roads Hotel” sh.p.k. NUIS/NIPT M02407023J”. Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

VLERËSOI:

- Komiteti i Investimeve Strategjike me Vendimin Nr. 1/6, datë 05.04.2022, ka vendosur miratimin e statusit strategjik për projektin “White Roads Hotel”, me subjekt “White Roads Hotel” sh.p.k. NUIS M02407023J.
- Nëpërmjet VKM-së Nr. 593 datë 07.09.2022 u miratua lidhja e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata ndërmjet subjektit White Roads Hotel dhe ministrisë përgjegjëse për ekonominë. Subjekti lidhi “Kontratë Qiraje” me çmim simbolik 1 euro/kontrata, më datë 03.10.2022, Nr. 5718 dhe Nr. Koleksioni 2640.
- Për të përmirësuar hapësirat dhe funksionalitetin e këtij projekti, në përputhje me standartet më të mira të brand-it, subjekti kërkoi të marrë me qira një sipërfaqe shtesë

shtet në ZK 1739. Komiteti i Investimeve Strategjike me Vendimin Nr. 34/11 datë 01.08.2023, miratoi disa shtesa në VKIS Nr. 1/6 datë 05.04.2022, duke rritur dhe sipërfaqen e zhvillimit të projektit.

- Me VKM-në Nr. 770 datë 13.12.2024 iu miratua një shtesë dhe një ndryshim në Vendimin nr. 593, datë 7.9.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë, me tarifën 1 euro/ kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës dhe shoqërisë “White Roads Hotel” sh.p.k., me NUIS M02407023J, si qiramarrës, të pronave të paluajtshme shtetërore në zonën kadastrale 1739, Bashkia Himarë, pjesë e fondit të Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike (FPPMIS).
- Kontrata ekzistuese me tarifën 1 euro/kontrata e datës 03.10.2022, Nr. 5718 dhe Nr. Koleksioni 2640 u amendua me kontratën me Nr. Repertori 9912 dhe Nr. Koleksioni 4027 datë 19.12.2024.
- Subjekti me shkresë zyrtare ka kërkuar saktësim dhe miratim të koordinatave të plazhit të VKIS Nr. 1/6, datë 05.04.2022 dhe VKIS Nr. 34/11 datë 01.08.2023 dhe unifikimin në një vendim të vetëm të koordinatave të vijës bregdetare sipas hartave që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Pika 8 e vendimit nr. 1/6, datë 05.04.2022 të Komitetit të Investimeve Strategjike ndryshohet si më poshtë vijon:

“Miratohet masa mbështetëse vënie në dispozicion e bregut të detit sipas nenit 29 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas koordinatave të hartave që përbëjnë Aneks 2 të këtij vendimi. Kjo masë ekzekutohet nëpërmjet marrëveshjes që do të lidhet ndërmjet investitorit dhe Agjencisë Kombëtare të Bregdetit (AKB), pas vënies në funksion të strukturës akomoduese turistike. Tarifa e kësaj marrëveshjeje përcaktohet me vendim të Këshillit Bashkiak.”.

2. Aneks 2 i Vendimit Nr. 1/6, datë 05.04.2022 të Komitetit të Investimeve Strategjike përditësohet me hartat që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Pika 10 e Vendimit nr. 1/6, datë 05.04.2022 të Komitetit të Investimeve Strategjike ndryshohet si më poshtë vijon:

“Në rast se përgjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit strategjik “White Roads Hotel” konstatohen të dhëna të pavërteta, të rreme apo ndryshime të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për miratimin e statusit strategjik të këtij projekti me procedurën e asistuar, Komiteti i Investimeve Strategjike ka të drejtë të anulojë vendimin për dhënien e statusit strategjik.”

4. Ky vendim publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

BLENDI GONXHJA

MINISTËR I FINANCAVE

PETRIT MALAJ

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

ANILA DENAJ

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

LAURA PLAKU (SARO)